



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:293432

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05780948

C.nr.1510/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.H nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.Onga Rahoveci, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, vlera e objektit të kontestit 2,103.30 euro, jashtë seancës, më datën 05.06.2024, mori këtë: të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditëses A.H nga Rahoveci, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

II. DETYROHEN paditësja A.H nga Rahoveci, që në emër të shpenzimeve të procedurës të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’i paguajë shumën prej euro 104.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.H, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 12.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, vlera e objektit të kontestit 2,103.30.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 15.03.2024, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë e vetme në këtë çështje kontestimore, ngase sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, në nenin 8 është përcaktuar se “Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”. Në asnjë pikë të vendimit të përshkruar nuk është obliguar Komuna e Rahovecit që të zbatojë këtë vendim. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejueshme padinë e paditëses A.H, lidhur me kompensim të diferencës së pagës për kualifikim, në shumë prej 2,103.30 euro, për faktin se gjatë shqyrtimit paraprak të padis ka kontestuar se lidhur me këtë çështje juridike, e cila është objekt i kësaj padie është vendosur me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër të lëndës C.nr.1211/2023, të datës 05.02.2024. Kjo gjykatë këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së, ashtu që është detyruar paditësi që të kompensojë shpenzimet të paditurës Komunës së Rahovecit 100 6502 5000 0012, pranë BQK-së, dhe të në emër të përpilimit të përgjigjes në padi në shumën prej 104.00 euro.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 al. 1 pika d., të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1510/2023, më datën 05.06.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.